

ANALIZË STATISTIKORE E TREGUESVE TË INSPEKTIMIT

Informacion i përpunuar i të dhënave të inspektimeve për VITIN 2018,
realizuar nga ISHPSHSH

VITI 2018

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, si një faktor i rëndësishëm i tregut të punës, ka udhëhequr e drejtuar punën, duke kontribuar ndjeshëm në rritjen e nivelit të zbatueshmërisë së Legjislacionit të Punës, për:

- 1. Sigurimin e zbatimit të dispozitave ligjore të Legjislacionit të Punës**
- 2. Këshillimin teknik të punëdhënësve dhe punëmarrësve mbi rreziqet e moszbatimit të ligjit.**

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka patur pjesë të punës inspektuese arritjen e objektivave:


- Rritjen e besueshmërisë, nëpërmjet trajtimit dhe dhënies zgjidhje të ankesave të ardhura nga punëmarrës dhe punëdhënës.
- Minimizimin e punës informale nëpërmjet forcimit të kontrollit, dhe marrjes së masës “pezullim” për çdo punëmarrës të evidentuar në punë pa siguracion, dhe sigurimin e tij konform legjislacionit, pa të cilin nuk lejohet të vazhdojë punën.
- Orientimin e kontrolleve drejt aktiviteteve ekonomike që paraqesin rrezikshmëri të lartë për siguri e mirëqenie në punë të punëmarrësit.
- Forcimin e kontrollit në sektorët e shërbimeve sidomos gjatë sezoneve turistike duke organizuar kontroll në Hotel-Bar-Restorante, kryesisht në sezone piku, me synim minimizimin e formave të punësimit që vijnë në kundërshtim me Legjislacionin e Punës, (në vëmendjen tonë punësimi i të miturve), minimizimi i punësimit pa kontrata pune sipas një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës konform Legjislacionit të Punës.
- Monitorimin e vazhdueshëm të punës ndaj gjithë strukturës inspektuese, duke ofruar mbështetje për kryerjen në mënyrë sa më korrekte të detyrës.
- Monitorimin, analizimin dhe vlerësimin e dosjeve të hetimit të aksidenteve në punë.
- Evidentimin e mangësive të punës së zhvilluar nga Drejtoritë Rajonale të ISHP-së .
- Inspektimin online si sfidë dhe shtrirja e tij në çdo inspektim.

Në lidhje me shërbimet shoqërore e shëndetësore:

- garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- verifikimin respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, nëpërmjet kontrolleve, të të gjithë strukturave të shërbimit të përkujdesit shoqëror.
- Vlerësimin e standarteve për subjektet që duhet të liçensohen.
- Inspektimin e ankesave dhe kërkesave të përfituesve dhe strukturave, të cilat kanë në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Vlerësimi i nevojave sociale kryesore të komunitetit në nevojë për bashkëpunim me strukturat e pushtetit vendor.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, me Vendim të Këshillit të Ministrave operon i organizuar në Drejtori Qendrore dhe 12 Degë Rajonale
Drejtoria Qendrore e ISHPSHSH e drejtuar nga Kryeinspektori, përbehet nga 3 drejtori teknike dhe 1 drejtori mbështetese.

Inspektimi Punës në Shqipëri operon në 12 Degë Rajonale në të gjithë vendin, i drejtuar nga Kryeinspektori.




Gjatë viti 2018, angazhimi i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ka patur vëmendje të shtuar në përmirësimin e marrëdhënies me biznesin, sigurimin e transparencës në vendimarrje, rritjen profesionale të inspektorëve, e të gjitha së bashku, për t'i shërbyer rritjes së nivelit të zbatueshmërisë së dispozitave ligjore të Legjislacionit të Punës.

Mbështetur në dy ligjet bazë të inspektimit, Ligji Nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe Ligji Nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin e Punës”, gjatë Vitit 2018, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ka kryer gjithsej 12297 inspektime në subjekte Private dhe Shtetërore dhe ka inspektuar e këshilluar 291244 punëmarrës.

Nga viti në vit vërehet rritje e mesatares së vendeve të punës inspektuar e këshilluar, çka tregon, vëmendje e shtuar ndaj subjekteve e punëmarrësve, duke qënë më pranë në këshillimin e zbatimit të ligjit, si dhe në ndëshkimet e abuzuesve me të.

	Private dhe Shtetërore			Vetëm Private		
	Inspektime Total (P+Sh)	Nr i Punëmarrësve (P+Sh)	Mesatare e vendeve të punës për subjekt	Inspektime Total (Private)	Nr i Punëmarrësve	Mesatare e vendeve të punës për subjekt
Viti 2016	11299	219114	19.4	11235	210320	18.7
Viti 2017	7958	182154	22.9	7923	176744	22.3
Viti 2018	12297	291244	23.7	12222	272296	22.3



Nga monitori i inspektimeve realizuar gjatë Vitit 2018 kemi:

Lloji i inspektimit	Subjekte te inspektuara	Subjekte me denime administrative (paralajmerim +gjoba+pezullim)	Kontribues të munguar në skemën e sigurimeve, evidentuar gjatë procesit të inspektimit
Inspektime të programuara	11354	1958	978
Inspektime për shkak aksidenti në punë	162	114	21
Inspektime për shkak ankese	467	173	55
Inspektime rastësore (shkelje flagrante evidente)	314	323	526
Total Inspektime	12297	2568	1580
20.9% e inspektimeve janë inspektime me dënime administrative			
89.2% e inspektimeve janë inspektime me shkelje të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës			

Në 89.2% të rasteve të inspektimeve me shkelje të dispozitave ligjore, vlen të përmendim se:

49% e shkeljeve, janë shkeljet e dispozitave ligjore të Kodit të Punës si dhe të VKM -ve në zbatim të tij, ndërkohë

33% janë shkeljet e dispozitave ligjore të ligjit Nr. 10237 “Për Sigurinë e Shëndetin në Punë” dhe VKM -ve në zbatim të tij.

Pjesa tjetër e dispozitave ligjore të shkelura kanë të bëjnë me dispozitat e tjera të Legjislacionit të Punës ku: Nxjitja e Punësimit zë 5%, Punësimit të të huajve 0.3%, Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore 0.6%.

Nga dispozitat e Kodit të Punës, evidentuar në parregullsi për zbatimin e tyre rëndisim:

- Kohëzgjatja e punës dhe e pushimeve në masën 30% e ku:
 - Shtesa mbi pagë në masën 29.9%
 - Puna në ditën e diel ose në ditët e festave zyrtare në masën 25%
 - Kompensimi në masën 20%
 - Pushimet vjetore/kohëzgjatja në masën 9.3%
 - Regjistri/ dhe VKM në zbatim të tij, në masën 5%.
- Lindja e marrëdhënieve të punës/forma e kontratës së punës në masën 11%.
- Paga/domosdoshmëria/mënyra e pagesës/përlllogaritja e pagës në masën 7%.
- Përfundimi i marrëdhënieve të punës në masën 3.4%.
- Sigurimi dhe mbrojtja e shëndetit/Kodi i Punës në masën 33%, ku vlen të përmendim:
 - Kualifikimi i punëmarrësve. Marrja e masave mbrojtëse
 - Masa të përgjithshme
 - Mjetet fikse
 - Pajisje individuale

- e. Instruksione për punëmarrësit
- f. Instalimet sanitare

Nga shkeljet e dispozitave ligjore të ligjit Nr. 10237 “Për Sigurinë e Shëndetin në Punë” dhe VKM –ve, evidentuar gjatë inspektimeve, në zbatim të tij rëndisim:

- a. Përpilimi i dokumentit të vlerësimit dhe parandalimi të rrezikut, në masën 19%
- b. Ndihma e parë, mbrojtja kundër zjarrit dhe evakuimi i rreziqeve të rënda në masën 16%
- c. Garantimin e zbatimit të masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale në masën 11%
- d. Informimi i punëmarrësve në masën 10%.
- e. Shërbimi mjekësor i punës në masën 5%.
- f. VKM-të në zbatim të ligjit Nr. 10237 “Për Sigurinë e Shëndetin në Punë”.

Vlen të theksojmë punën e kryer nga muaji maj 2018, ku ritmi i punës në drejtim të cilësisë së inspektimit ka rezultate direkte në zbatueshmërinë e dispozitave ligjore të Legjislacionit të Punës, nga subjektet private eshteterore.

Kështu 80% e inspektimeve të kryera gjatë vitit 2018, janë rezultat i punës intensive realizuar maj-dhjetor 2018.

Eficencën e inspektimeve realizuar për periudhën maj-dhjetor 2018, e tregojnë rezultatet konkrete të këtyre inspektimeve krahasimisht me të dhënat e vitit e ku janë realizuar;

72.4% e inspektimeve për shkak ankese

97.5% e inspektimeve rastësore, iniciuar në subjekte me dyshime për shkelje flagrante të legjislacionit të punës

95.6% e zbatueshmërisë së informalitetit në punë

95.8% e rekuperimit të kontribuesve të munguar në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore gjatë procesit të inspektimit

96.7% e masave administrative “Pezullim” për shkelje flagrante të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës

78.3% e masave administrative si dënime kryesore “Paralajmërim”

75.4% e masave administrative si dënime kryesore “Gjobë”


Inspektimet e realizuara në Vitin 2018, janë në 92.3% të tyre, inspektime realizuar pas programimit. Programimi i inspektimeve bëhet kryesisht bazuar në historikun e inspektimeve realizuar më parë, duke synuar në aktivitete me rrezikshmëri për punësim informal, apo rrezikshmëri sa i takon sigurisë dhe shëndetit në punë, subjekteve të reja e të programuara në kuadër të këshillimit e të njohjes me dispozitat e legjislacionit të punës.

Këto programime janë:

- Riinspektimeve në rastet e subjekteve me detyra e shkelje ligjore për t'u korigjuar e të lëna në inspektimet e mëparshme.
- Realizuara në turne të dyta e të treta, apo të festave zyrtare, ditët e pushimeve javore, arsye këto mbi evidentimin e zbatueshmërisë së marrëdhënieve të punës e jo vetëm, tëpunëmarrësve e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në këto periudha kohore, e ku marrëdhënia e punës merr një këndvështrim të veçantë sipas Kodit të Punës.
- Në kuadër të luftës kundër informalitetit, punësimit të të miturve, apo respektimit të kohës së punës e pagesave për orët shtesë në periudhën e sezonit turistik.
- Në bashkëpunim me institucione të tjera, e konkretisht gjatë këtij viti, në kuadër të bashkëpunimit me Zyrën Ndërkombëtare të Punës, prioritet i të cilave kanë qënë inspektimet në aktivitetet ndërtuese.
- Në inspektime shërbimi, e konkretisht të inspektimeve pas kërkesës së subjekteve për punësim të miturish, autorizim për orët shtesë, apo leje pune për ushtrim aktiviteti.

Aktualisht nga inspektimet e realizuara gjatë vitit sipas 12 degëve rajonale rezulton se:

Nr	Deget Rajonale	Inspektime gjithsej	Inspektime të programuara	Inspektime jashtë programi	% e Inspektime jashtë programi, kundrejt totalit, sipas degëve
1	Berat	546	516	30	5.5%
2	Dibër	365	310	55	15.1%
3	Durrës	1225	1119	106	8.7%
4	Elbasan	1006	944	62	6.2%
5	Fier	788	756	32	4.1%
6	Gjirokastrë	515	496	19	3.7%
7	Korçë	760	710	50	6.6%
8	Kukës	300	268	32	10.7%
9	Lezhë	457	420	37	8.1%
10	Shkodër	803	751	52	6.5%
11	Tiranë	4455	4064	391	8.8%
12	Vlorë	1068	1000	68	6.4%
13	Qendër	9	-	9	100.0%
	Total	12297	11354	943	7.7%



Theksojmë se, nga inspektimet e realizuara jashtë programimi, 49.5% të tyre e zënë inspektimet për shkak ankese, 17.2% inspektimet për shkak aksidenti në punë dhe 33.3% e zënë inspektimet rastësore.


Nr	Deget Rajonale	Inspektime jashtë programimi	Inspektime për shkak aksidenti në punë	% e Inspektime për shkak aksidenti në punë, kundrejt totalit të inspektimeve të jashtë programimi, sipas degëve	Inspektime për shkak ankese	% e Inspektime për shkak ankese, kundrejt totalit të inspektimeve të jashtë programimi, sipas degëve	Inspektim e rastesore/i ndicje per shkelje flagrante	% e Inspektime rastesore/indicje per shkelje flagrante, kundrejt totalit të inspektimeve të jashtë programimi, sipas degëve
1	Berat	30	10	33.3%	11	36.7%	9	30.0%
2	Diber	55	30	54.5%	11	20.0%	14	25.5%
3	Durres	106	19	17.9%	48	45.3%	39	36.8%
4	Elbasan	62	15	24.2%	4	6.5%	43	69.4%
5	Fier	32	9	28.1%	18	56.3%	5	15.6%
6	Gjirokaster	19	6	31.6%	2	10.5%	11	57.9%
7	Korce	50	11	22.0%	15	30.0%	24	48.0%
8	Kukes	32	6	18.8%	6	18.8%	20	62.5%
9	Lezhe	37	8	21.6%	20	54.1%	9	24.3%
10	Shkoder	52	8	15.4%	18	34.6%	26	50.0%
11	Tirane	391	33	8.4%	274	70.1%	84	21.5%
12	Vlore	68	6	8.8%	32	47.1%	30	44.1%
13	Qender	9	1	11.1%	8	88.9%	0	0.0%
	Total	943	162	17.2%	467	49.5%	314	33.3%

INSPEKTIVE PËR AKSIDENT NË PUNË, PËR SHKAK ANKESE, DHE PËR INDICJE TË SHKELJEVE FLAGRANTE

■ % e Inspektive rastësore/indicje për shkelje flagrante, kundrejt totalit të inspektiveve të jashtë programimi, sipas degëve

■ % e Inspektive për shkak ankese, kundrejt totalit të inspektiveve të jashtë programimi, sipas degëve

■ % e Inspektive për shkak aksidenti në punë, kundrejt totalit të inspektiveve të jashtë programimi, sipas degëve



Krahasimisht me një vit më pare, kemi numër të shtuar në 31 herë më shumë të rasteve të inspektiveve për për indicje të shkeljeve flagrante të ligjit, si dhe gati 2 herë më shumë të inspektiveve për shkak ankese.

	Inspektive rastësore/për indicje të shkeljeve flagrante	Inspektive për shkak ankese
Viti 2017	10	264
Viti 2018	314	467
raste më shumë këtë vit	304	203

Disa nga treguesit e përgjithshëm statistikorë të inspektimeve realizuar gjatë vitit 2018, nga trupa inspektuese e ISHPSHSH-së janë:

Inspektime në subjekte Private + Shteterore	12297
Me një mesatare prej 23.7 vende pune për subjekt	
Inspektime në subjekte Private	12222
Që zënë 99% të totalit të inspektimeve	
Inspektime tematike	1960
Që zënë 17% të totalit të inspektimeve të programuara	
Inspektime tematike në kuadër të deregulimit	178
Që zënë 9% të totalit të inspektimeve tematike	
Inspektime tematike në turn të dytë të tretë, ditët e fesatave e zyrtare e ditët e pushimit javor	278
Që zënë 14.2% të totalit të inspektimeve tematike	
Inspektime për shkak Ankese	467
Që zënë 3.8% të totalit të inspektimeve	
Inspektime për shkak Aksidenti	162
Që zënë 1.3% të totalit të inspektimeve	
Inspektime Rastësore	314
Që zënë 2.6% të totalit të inspektimeve	
Inspektime ku është mbajtur masë urgjente “Pezullim”	855
Që zënë 7% të totalit të inspektimeve	
Inspektime ku është mbajtur masa administrative “Paralajmërim”	1538
Që zënë 12.5% të totalit të inspektimeve	
Inspektime ku është mbajtur masa administrative “Gjobë”	175
Që zënë 1.4% të totalit të inspektimeve	
Vende pune të inspektuara (subjekte private e shteterore)	291244
Me një mesatare, 23.7 vende pune për subjekt, e ku 48.3% janë punëmarrëse femra	
Vende pune të inspektuara në subjektet private	272296
Me një mesatare prej 22.3 vende pune për subjekt e ku 49% janë punëmarrëse femra	
Punëmarrës pa kontrata individuale të evidentuar (në subjekte private)	3661
Ku 39% e tyre janë punëmarrëse femra	
Punëmarrës informal të evidentuar	1580
Ku 29.5% janë punëmarrëse femra	
Punëmarrës informal të futur në skemën e SSH, gjatë procesit të inspektimit	1515
Ku 30% janë punëmarrëse femra	
Punëmarrës të siguruar me pagë minimale	76282
Që zënë 26.2% e totalit të punëmarrësve	
Punëmarrëse femra, të siguruara me pagë minimale	38115
Që zënë 27% e totalit të punëmarrëseve femra	
Punëmarrës nën 18 vjeç të evidentuar	329
Ku 47% janë punëmarrëse femra	
Punëmarrës të mitur të autorizuar, gjatë procesit të inspektimit	295
Punëmarrës me aftësi të kufizuar	234
Ku 32% janë punëmarrëse femra	
Punëmarrës të huaj të evidentuar	2074

Punëmarrës të huaj, pa leje pune	20
Punëmarrës të aksidentuar	195
Ku 15.4% ishin punëmarrëse femra	
Punëmarrës të aksidentuar me vdekje	27
Ku 7.4% ishin punëmarrëse femra	

Disa krahasime me një vit më parë:

	Inspektime të kryera	Vende pune të inspektuara	Informal të evidentuar	Të siguruar gjatë procesit	Masa Urgjente/Pezullime	Gjoha
Viti 2018	12297	291244	1580	1515	855	175
Viti 2017	7958	182154	607	576	221	80
Krahasime (më shumë në 2018)	4339	109090	973	939	634	95


Nga të dhënat e inspektimeve të subjekteve ekonomike (private e shtetërore) raportuar nga degët rajonale të ISHPSHSH-së, në 12 qarqet e vendit, kemi:

Sipas llojit të aktiviteteve ekonomike të inspektuara, numri më i lartë i inspektimeve të kryera, edhe për vetë natyrën e aktiviteteve në vend (të dhëna zyrtare të INSTAT) është ai i aktiviteve tregëtare, Hotel-Bar-Restorante, që zënë 47.1% të inspektimeve të kryera në vit. Ndërkonë inspektimet në aktivitetet prodhuese zënë 20.6% të totalit të inspektimeve, aktivitetet e ndërtimit zënë 8.5%, aktivitete nën ndarjen “të tjera”17.9%.

• Bujqësi, pyje, peshkim	203
• Miniera karriera	175
• Ndërmarrje Prodhuese	2539
• Elektricitet, gaz, ujë	66
• Tregti, hotel-bar-restorante	5789
• Ndërtim	1047
• Transport, magazinim, telekomunikacion	181
• Finance, shërbime të sigurimeve	101
• Aktivitete të tjera	2196

Inspektime në aktivitetet ekonomike të licensuara, sipas llojit të aktivitetit

INSPEKTIVE SIPAS LLOJIT TË AKTIVITETIT



Masat administrative

Në inspektimet e kryera, bazuar në procedurë inspektimi e në funksion të evidentimit të zbatueshmërisë së Legjislacionit të Punës nga punëdhënës e punëmarrës, dhe rregullueshmërive ligjore për t'u zbatuar, inspektorët e punës marin këto masa:

1. Përmirësime në zbatueshmërinë e ligjit, me detyra konkrete për t'u realizuar, me afate kohore.
2. "Pezullim" të pjesshmë apo të të gjithë aktivitetit, për periudhë kohore deri në rregullueshmëri të shkeljes.
3. "Paralajmërim" si masë ndëshkuese për shkeljet e evidentuara.
4. "Gjobë" si masë ndëshkuese të kërkesave ligjore, parashikuar në legjislacion.

Masa ligjore gjatë inspektimeve të vitit 2018 janë.

Deget Rajonale	Inspektime	Inspektime me Pezullim/Marrëdhënie pune dhe Siguri në punë	Inspektime me Paralajmerim	Inspektime me Gjore	Vlere (.000)
Berat	546	27	390	9	1038
Dibër	365	60	76	12	1210
Durrës	1225	82	207	33	3958
Elbasan	1006	100	40	12	6330
Fier	788	21	57	3	1400
Gjirokastrë	515	12	7	1	100
Korçë	760	70	33	14	1652
Kukës	300	54	35	9	700
Lezhë	457	30	104	8	1810
Shkodër	803	86	18	7	1930
Tiranë	4455	204	138	58	9026


Vlorë	1068	107	429	8	600
Qendër	9	2	4	1	100
Total	12297	855	1538	175	29854

Masa ligjore “Pezullim”

Masa ligjore “pezullim”, për shkeljet flagrante të dispozitave të legjislacionit të punës është aplikuar në 855 inspektime, nga të cilat 844 ose 98.7% e tyre janë për rregullueshmëritë e shkeljeve ligjore evidentuar gjatë inspektimeve, për marrëdhënie punë jo korrekte dhe 11 janë për rregulleshmëritë e shkeljeve ligjore evidentuar gjatë inspektimeve për siguri dhe shëndet në punë.

Kjo masë ligjore është aplikuar më së shumti në degën rajonale Tiranë, Vlorë, Dibër, Kukës, Shkodër e Korçë në mbi 9% të inspektimeve realizuar në këtë periudhë nga këto degë rajonale.

Për 12 degët rajonale kjo e dhënë rezulton si më poshtë:




Masa administrative ”Pezullim” është mbajtur kryesisht në inspektimet me punëmarrës informal të evidentuar.

Ndëkohë sipas llojit të aktivitetit ekonomik rezulton se kjo masë është aplikuar më së shumti në numër në Tregëti, hotel-bar-restorante

Lloj aktiviteti	Inspektime	Raste inspektimesh me mase "Pezullim"	Inspektime me pezullim në % kundrejt totalit të inspektimeve për lloj aktiviteti
Bujqësi, pyje, peshkim	203	35	17.7%
Miniera karriera	175	24	13.7%

Ndërmarrje Prodhuese	2539	138	5.4%
Elektricitet, gaz, ujë	66	0	0.0%
Tregti, hotel-bar-restorante	5789	443	7.7%
Ndërtim	1047	67	6.4%
Transport, magazinim, telekomunikacion	181	11	6.1%
Finance, shërbime të sigurimeve	101	6	5.9%
Aktivitete të tjera	2196	131	6.0%
Total	12297	855	7.0%

Por e parë në % me numrin total të inspektimeve sipas llojit të aktiviteti kjo masë administrative rezulton:



Disa të dhëna krahasuese me vitet e tjera në lidhje me aplikimin e masës “Pezullim”, paraqiten si më poshtë.

Te dhenat e inspektimeve	Inspektime Total (Private+Shteterore)	Nr i subjekteve me masë “Pezullim”	% e subjekteve me mase “Pezullim”	Nr i subjekteve me “Gjobë “	% e subjekteve te gjobitura
Viti 2016	11,299	596	5.3%	117	1.0%
Viti 2017	7,958	221	2.8%	80	1.0%
Viti 2018	12,297	855	7.0%	175	1.4%


Shifrat tregojnë rritje në përdorimin e kësaj mase, si një mjet i përshatatshëm dhe efikas në rregullueshmërinë e shkeljeve ligjore dhe kryesisht të formalizimit e punësimit informal.

Masa administrative “Paralajmërim”

Masa administrative “Paralajmërim”, për shkeljet e dispozitave të legjislacionit të punës është masa që praktikohet më shumë në inspektimet e realizuara. Kështu, në 12297 inspektime të kryera në këtë periudhë, në 1538 inspektime është aplikuar kjo masë.


Krahasimisht me numrin e inspektimeve nga çdo degë rajonale, kjo masë ligjore është aplikuar në 71% të totalit të inspektimeve të realizuara nga dega Berat, në 40% të totalit të inspektimeve të realizuara nga dega Vlorë.

Për 12 degët rajonale kjo e dhënë rezulton si më poshtë:



Ndëkohë sipas llojit të aktivitetit ekonomik rezulton se kjo masë është aplikuar në 39.4% të totalit të inspektimeve realizuar në miniera kariera, inspektuar në këtë periudhë, në 33%, të rasteve të inspektimeve në aktivitetin elektrikitet gaz ujë.

	Inspektime	Raste inspektimesh me mase "Paralajmerim"	Inspektime me paralajmerim në % kundrejt totalit të inspektimeve për lloj aktiviteti
Bujqësi, pyje, peshkim	203	39	19.2%
Miniera karriera	175	69	39.4%
Ndërmarrje Prodhuese	2539	378	14.9%
Elektricitet, gaz, ujë	66	22	33.3%
Tregti, hotel-bar-restorante	5789	630	10.9%
Ndërtim	1047	172	16.4%
Transport, magazinim, telekomunikacion	181	20	11.0%
Finance, shërbime të sigurimeve	101	4	4.0%
Aktivitete të tjera	2196	204	9.3%
Total	12297	1538	12.5%




Masa administrative “Gjobë”

Masa administrative “Gjobë”, për shkeljet e dispozitave të legjislacionit të punës është aplikuar në 175 inspektime të kryera.

Krahasimisht me numrin e inspektimeve nga çdo degë rajonale, kjo masë ligjore është aplikuar në 1.4% të totalit të inspektimeve të realizuara nga 12 degët rajonale.

Lloj aktiviteti	Inspektime	Raste inspektimesh me mase "Gjobë"	Vlere gjobe (.000)	Inspektime me gjobe në % kundrejt totalit të inspektimeve për lloj aktiviteti	Vlere mesatare e gjobes (.000)
Bujqësi, pyje, peshkim	203	0	0	0.0%	0
Miniera karriera	175	16	2532	9.1%	158
Ndërmarrje Prodhuese	2539	49	13260	1.9%	271
Elektricitet, gaz, ujë	66	2	500	3.0%	250
Tregti, hotel-bar-restorante	5789	47	4598	0.8%	98
Ndërtim	1047	17	3216	1.6%	189
Transport, magazinim, telekomunikacion	181	2	148	1.1%	74
Finance, shërbime të sigurimeve	101	1	100	1.0%	100
Aktivitete të tjera	2196	41	5500	1.9%	134
Total	12297	175	29854	1.4%	171

Sipas llogaritjes së një mesatareje për lloj aktiviteti, vlerë mesatare e gjobave, rezulton më e madhe e aplikuar ne aktivitet prodhuese, elektrikitet gaz ujë, ndërtim e në miniera karriera, aktivitete këto me rrezishmëri të lartë për sigurinë e shëndetin në punë.



Inspektime për aksident në punë

Sa i takon inspektimeve për aksident në punë rezultojnë se sipas degëve rajonale, numri më i madh i inspektimeve për rast aksidenti në punë dhe i punëmarrësve të aksidentuar është në degën rajonale Dibër (në aktivitete minierare).


Deget Rajonale	Inspektime per aksident ne pune	Pezullim/M arredhenie pune	Pezullim/Siguri ne pune	Paralajmerim	Gjobe	Vlere (.000)	P/aksidentuar	P/Aksident me vdekje
Berat	10	-	-	5	3	324	11	-
Diber	30	2	1	20	7	840	42	8
Durres	19	-	1	9	6	2040	25	-
Elbasan	15	-	3	4	7	5350	17	5
Fier	9	-	-	4	2	1300	11	1
Gjirokaster	6	-	-	2	1	100	6	-
Korce	11	-	-	-	3	920	12	1
Kukes	6	-	-	-	-	-	8	3
Lezhe	8	-	-	4	3	300	12	1
Shkoder	8	-	-	5	1	480	11	-
Tirane	33	-	-	2	13	2364	32	7
Vlore	6	-	-	5	1	100	7	1
Qender	1	-	-	-	-	-	1	-
Total	162	2	5	60	47	14118	195	27

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik numri më i madh i rasteve të hetimit të aksidenteve në punë, rezulton në ndërmarrjet prodhuese.

Aksidente në punë të hetuara gjatë vitit 2018 nga ISHPSHSH, sipas llojit të aktivitetit rezultojnë:

Viti 2018	Subjekte te inspektuara per shkak aksidenti ne pune	Punemarres te aksidentuar	Punemarres te aksidentuar, me vdekje
<i>Bujqësi, pyje ,peshkim</i>	2	2	-
<i>Miniera, karriera</i>	35	44	6
<i>Ndërmarrje prodhuese</i>	40	50	4
<i>Elektricitet, gaz, ujë</i>	13	17	3
<i>Tregti, hotel-bar-restorante</i>	12	12	4
<i>Ndërtim</i>	24	26	5
<i>Transport, telekomunikacion</i>	2	2	-
<i>Finance, shërbime të sigurimeve</i>	1	1	-
<i>Aktivitete të tjera</i>	33	41	5
<i>Total</i>	<i>162</i>	<i>195</i>	<i>27</i>

INSPEKTIVE PER AKSIDENT NE PUNE, SIPAS LLOJIT TË AKTIVITETIT



Punëmarrësit.

Në lidhje me punëmarrësit e evidentuar në punë rezulton se:

48.4% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrëse femra

1.3% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës që punojnë pa kontrata individuale pune.

26.2% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës të siguruar në bazë të pagës minimale.

0.71% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës të huaj.

0.1% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës me aftësi të kufizuar.

0.1% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës nën 18 vjeç.

0.54% e punëmarrësve të evidentuar ishin punëmarrës të pasiguruar (informal)

0.01% e punëmarrësve të evidentuar ishin të aksidentuar.

Sipas degëve rajonale, kategoritë e të punësuarve evidentuar gjatë inspektimeve, rezultojnë:

Aktivitete private + shtetërore të inspektuara gjatë Vitit 2018

Deget Rajonale	Punemarres	Femra	Pa kontrata	P/page minimale	Te huaj	Me aftesi te kufizuar	Nen 18 Vjeç	Informal	U siguruan	Punm. aksidentuar
Berat	7757	3483	349	3790	158	0	0	32	32	11
Diber	12031	1890	151	1040	210	195	0	142	137	42
Durres	44335	24497	318	8197	57	0	116	180	177	25
Elbasan	8692	2770	59	4082	15	0	2	117	116	17

<i>Fier</i>	14617	4385	13	4881	106	0	0	34	34	11
<i>Gjirokaster</i>	3091	1697	240	1662	0	0	1	22	18	6
<i>Korce</i>	10556	3903	97	3165	483	0	0	129	125	12
<i>Kukes</i>	3062	961	92	1408	3	0	0	92	88	8
<i>Lezhe</i>	9114	4344	466	3982	166	8	11	71	66	12
<i>Shkoder</i>	14104	7886	464	7884	1	4	13	224	224	11
<i>Tirane</i>	144272	75403	522	28502	822	24	36	316	285	32
<i>Vlore</i>	17483	8524	889	7505	52	2	150	219	211	7
<i>Qender</i>	2130	1091	1	184	1	1	0	2	2	1
<i>Total</i>	291244	140834	3661	76282	2074	234	329	1580	1515	195

AKTIVITETET E NDËRTIMIT, INSPEKTIMET DHE TREGU I PUNËS I EVIDENTUAR NË KËTO AKTIVITETE

Në kuadër të bashkëpunimit me Zyrën Ndërkombëtare të Punës, bazuar në Projektin PPÇS (Platforma e Punësimit dhe Çështjeve Sociale) i financuar nga Komisioni European me komponent që synon forcimin e inspektorateve të punës së Ballkanit Perëndimor, gjatë periudhës Maj-Qershor 2018, trupa inspektuese ka kryer fushatë sensibilizuese e inspektuese në sektorin e ndërtimit.

Objektivat e kësaj fushate ishin:

- Rritja e ndërgjegjësimit për rreziqet ekzituese në ndërtim
- Promovimi i praktikave të mira kundrejt rreziqeve specifike të rënies nga lartësitë dhe përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale në kompanitë e ndërtimit duke kontribuar në zvogëlimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.
- Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet inspektoriatëve të ndryshëm kombëtarë, shkëmbimin e informacionit, praktikave të mira, metodologjive të inspektimit dhe trajnimit, duke përfshirë mundësinë e organizimit të vizitave nga ekipet e përbashkëta të bashkëpunimit.

Gjatë kësaj fushate u përdorën edhe Postera dhe fletëpalosje për punën e padeklaruar, broshura mbi rreziqet dhe praktikatat e sigurta në ndërtim, në lidhje me rëniet nga lartësitë dhe përdorimin e MPM (Mjeteve Personale Mbrojtëse).

Sektori i ndërtimit është sektor i klasifikuar si Aktivitet Prodhues i të mirave, dhe jo si aktivitet Prodhues i shërbimeve, së bashku me Industrinë dhe Bujqësinë, Pyjet, Peshkimin.

Kështu nga të dhënat e INSTAT, gjëndja e fund vitit 2017, Aktivitetet ndërtuese zënë 8.5% të Prodhuesve të të mirave.


Gjendje në fund të vitit 2017/ End of the year 2017

Aktiviteti Ekonomik	Gjithsej Total	Shqiptare Albanian	Të huaja përbashkëta Foreigner and Join	e të Të huaja Foreigner
Gjithsej	162,452	156,157	3,704	2,591
Prodhuesit e të mirave	53,250	51,605	928	717
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	37,684	37,613	23	48
Industria	11,066	9,970	587	509
Ndërtimi	4,500	4,022	318	160
Prodhuesit e shërbimeve	109,202	104,552	2,776	1,874
Tregtia	48,873	47,152	977	744
Transporti dhe magazinimi	5,928	5,807	73	48
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	21,909	21,572	202	135
Informacioni dhe komunikacioni	2,927	2,588	207	132
Shërbime të tjera	29,565	27,433	1,317	815

Sektori i ndërtimit në vite, sipas të dhënave nga INSTAT, rezulton të jetë një sektor në konsolidim, për vetë faktin se sa u takon numrit të aktiviteteve ka rënie nga viti në vit kundrejt aktiviteteve

ekonomike aktive (sic tregohet dhe nga tabela), e ndërkohë kemi rritje të aktiviteteve të reja ndërtuese të regjistruara ndër vite, kundrejt këtij aktiviteti.

	Total aktivitete	Nga te cilat total Aktivitete Ndertimi	% e aktiviteteve ndertuese kundrejt totalit	Aktivitete ndertim te reja te regjistruara sipas viteve	% e aktiviteteve ndertuese te regjistruara kundrejt totalit, te aktiviteteve ndertuese
fund viti 2013	111,154	4,819	4.3%	368	7.6%
fund viti 2014	112,537	4,575	4.1%	380	8.3%
fund viti 2015	152,288	4,946	3.2%	671	13.6%
fund viti 2016	160,679	4,624	2.9%	513	11.1%
fund viti 2017	162,452	4,500	2.8%	676	15.0%



ISHPSHSH, është angazhuar në këtë fushatë, në rajonet Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, dhe Korçë me një staf prej 65 inspektore pune të këtyre degëve rajonale.

Trupa inspektuese e angazhuar në këto inspektime ka realizuar 480 inspektime, verifikime, keshillime me 9272 vende pune gjithsej.

Në këto aktivitete kanë rezultuar se 7.5% e të punësuarve janë punëmarrëse femra.

27% e punëmarrësve të evidentuar paguhën e sigurohen me pagë minimale.

12.7% e punëmarrësve të evidentuar punojnë mbi 48 orë pune në javë.

10.5% e punëmarrësve të evidentuar punojnë mbi 40 orë pune në javë.

Për 1.3% të punëmarrësve të evidentuar pushimet vjetore të paguara janë nën 28 ditë kalendarike.

0.5% e punëmarrësve të evidentuar, punonin pa kontratë pune individuale.

0.4% e punëmarrësve të evidentuar, ishin punëmarrës informal (të pasiguruar).

Për shkeljet flagrante të kërkesave ligjore në 16 subjekte është marrë masa administrative “Pezullim”, deri në rregullueshmëri të situatës.

Në 78 subjekte ose në 16.3% të totalit të subjekteve të inspektuara, është marrë dënimi administrativ kryesor “Paralajmërim”, e ndërkohë në 3 prej tyre është marrë dënim administrativ kryesor “Gjobë” me vlerë totale 1200000 leke.

Në ndihmë të inspektimit, të këtyre subjekteve, për një panoramë të situatës së sigurisë dhe shëndetit në punë, me bashkëpunimin e ngushtë me Zyrën Ndërkombëtare të ILO-s dhe përfaqësuesve të tyre në Shqipëri, është bërë e mundur që krahas dokumenteve standarte inspektuese, inspektimi të pasqyrohet dhe me dokumentin në formë pyetësori “Aneksi 1”.


Për të gjitha aktivitetet ndërtuese të anketuara rezulton se ka qënë e nevojshme ndërhyrja në 1269 raste të rrezikshme në vendin e punës, e ku sipas shkallës së rrezikshmërisë të vlerësuar në vendin e inspektimit rezulton se :

Ndërhyrje, për shkallë rreziku **shumë të lartë** ka qënë e nevojshme 1.1% të rasteve.

Ndërhyrje, për shkallë rreziku **të lartë** ka qënë e nevojshme në masën 9.9% të rasteve.

Ndërhyrje, për shkallë rreziku **të mesme** ka qënë e nevojshme në masën 32.4% të rasteve.

Ndërhyrje, për shkallë rreziku **të ulët** ka qënë e nevojshme në masën 56.6% të rasteve.



Gjatë inspektimeve të kantierëve ndërtuesë, ka rezultuar se në 67.2% e subjekteve të inspektuara kishte më shumë se një punëdhënës në vendin e ndërtimit.




Në këto kantierë ndërtimi, me më shumë se një punëdhënës, koordinimi ndërmjet tyre ka rezultuar se në masën 80% të tyre ka një koordinim dhe në 20% ky koordinim mungonte.



Për kantierët e ndërtimit, ku koordinimi mes punëdhënësve mungonte, apo dhe në ato kantierë, ku kishte koordinim, por ishte e nevojshme ndërhyrje për përmirësim e tij, është parë e arsyeshme ndërhyrja në 28.5% të rasteve.

MOS KOORDINIM NDËRMJET PUNËDHËNËSVE NË VENDIN E NDËRTIMIT




Sipas shkallës së rrezikshmërisë, ndërhyrjet për moskoordinim mes punëdhënësve në kantierët e ndërtimit është vlerësuar:

1.1% shkallë rrezikshmërie shumë e lartë.

53.3% shkallë rrezikshmërie e mesme

45.6% shkallë rrezikshmërie e ulët.

MOS KOORDINIM NDËRMJET PUNËDHËNËSVE NË VENDIN E NDËRTIMIT KA NEVOJË PËR NDËRHYRJE, PASI VENDI I PUNËS ËSHTË ME RREZIKSHMËRI TË NJË SHKALLE:



Informimi dhe trajnimi i punëmarrësve.

Gjatë inspektimeve dhe ankimimeve të bëra në subjektet e ndërtimit, kanë rezultuar se në 20.4% të totalit të subjekteve, punëmarrësit nuk janë të informuar dhe të trajnuar për rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar dhe për masat parandaluese.



Nga totali i subjekteve të anketuara dhe të inspektuara në 29.8% të tyre ka qënë e nevojshme ndërhyrje, dhe marrje e masave për, informimin e punëmarrësve dhe trajnimit e tyre, për rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar dhe për masat parandaluese.



Mos informimin dhe trajnimin e punëmarrësve, për rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar dhe për masat parandaluese, ka nevojë për ndërhyrje, pasi vendi i punës është me rrezikshmëri të një shkalle:


Në masën 41.2%, shkallë rrezikshmërie e Ulët

Në masën 44.9%, shkallë rrezikshmërie e Mesme

Në masën 13.2%, shkallë rrezikshmërie e Lartë

Në masën 0.7%, shkallë rrezikshmërie Shumë e Lartë


MOS INFORMIMIN DHE TRAJNIMIN E PUNËMARRËSVE, PËR RREZIQET NDAJ TË CILAVE JANË TË EKSPOZUAR DHE PËR MASAT PARANDALUESE, KA NEVOJË PËR NDËRHYRJE, PASI VENDI I PUNËS ËSHTË ME RREZIKSHMËRI TË NJË SHKALLE:



Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse individuale

Anketimi tregon se në masën 30.7% të totalit të subjekteve ndërtuese punëmarrësit përdorin pajisjet mbrojtëse individuale.

Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse individuale




Pavarësisht numrit të madh të subjekteve që sigurojnë përdorimin e masave mbrojtëse individuale, për punëmarrësit e tyre, ndërhyrja sipas shkallës së riskut ka qënë:

Në masën 42.6%, shkallë rrezikshmërie e Ulët

Në masën 39.1%, shkallë rrezikshmërie e Mesme

Në masën 16%, shkallë rrezikshmërie e Lartë

Në masën 2.4%, shkallë rrezikshmërie Shumë e Lartë



Rreziku i rënies nga lartësia, gjatë punës për instalimin e skelave

Në subjektet e anketuara, rreziku i rënies nga lartësia gjatë punës së instalit të skelave, ka qënë present në 6.1% të tyre.



Sipas shkallës së riskut, ndërhyrjet për këtë kategori subjektësh kanë rezultuar:

Në masën 72%, për shkallë rrezikshmërie të Ulët

Në masën 12%, për shkallë rrezikshmërie të Mesme

Në masën 14%, për shkallë rrezikshmërie të Lartë

Në masën 2%, për shkallë rrezikshmërie Shumë të Lartë

Rreziku i rënies nga lartësia, për shkak të mungesës së rrethimit të sigurisë

Kanë rezultuar se në 7.4% të subjekteve të ndërtimit ekzistonte rreziku i rënies nga lartësia për shkak të mungesës së rrethimit të sigurisë.


Ndërhyrjet për rrezikun e rënies nga lartësia, për shkak të mungesës së rrethimit të sigurisë, kanë nevojë për ndërhyrje:

Në masën 58.5%, për shkallë rrezikshmërie të Ulët

Në masën 12.3% për shkallë rrezikshmërie të Mesme


Në masën 26.2% për shkallë rrezikshmërie të Lartë

Në masën 3.1% për shkallë rrezikshmërie Shumë të Lartë



Rreziku i rënies nga shkallët apo vinçi.

Nisur dhe nga proceset e punës të subjekteve të kontrolluara, rreziku i rënies nga vinçi apo shkallët, ka rezultuar në 2.7% të aktiviteteve të kontrolluara.



Ndërhyrjet me masa konkrete për këtë rrezik kanë qënë në 86% të ndërhyrjeve për shkallë të ulët rreziku, 7% për shkallë të mesme e të lartë rreziku.

Dyshemetë e pasigurta e të rrezikshme

Në 11.4% të totalit të subjekteve të kontrolluara ekzistonte mundësia e lëndimit për shkak të punës në dysheme të pasigurta.

Gjithsej për këtë rrezik, është parë e arsyeshme ndërhyrja në 41 raste me risk të ulët të lëndimeve që mund të shkaktoheshin nga një dysheme e pasigurt, në 39 raste, me risk të mesëm për dysheme të pasigurt dhe në 6 raste me risk të lartë lëndimesh, për dysheme të pasigurt.

Lëndimet për shkak të punës në lartësi.

Në 39 raste të kontrolluara ka ekzistuar mundësia e lëndimit për shkak të punës në lartësi dhe të mos sigurimit të mirë të skelave apo vinçit për ngritjen e materialeve, e ku ndërhyrja ka qënë e nevojshme për shkak të rriskut të ulët në masën 72% të ndërhyrjeve, në 16 % për risk të mesëm dhe 10% për risk të lartë.

Rreziku nga mos fiksimi i skelave sipas standartit.

Në 44 raste të inspektuara mos fiksimi i skelave sipas standartit përbënte rrezik për lëvizshmërinë e tyre.

Trajnimi specific i punëmarrësve që merren me montimin dhe ngritjen e skelave.

Në 133 raste, punëmarrësit që merren me montimin dhe ngritjen e skelave kanë qënë me trajnimin e duhur. Për pjesën tjetër janë marrë masat e nevojshme për ndërhyrje urgjente, dhe për ndërhyrje me risk të lartë në 2.5% të rasteve.

Siguria e gropave apo hapsirave në dysheme.

Në këto kontrole, kanë rezultuar se në 89% të tyre, ishin marë masat mbrojtëse për parandalimin e rreziqeve nga hapsira në dysheme, ndërkohë, për pjesën tjetër në 1.4% ndërhyrja për marrjen e këtyre masave, ka qënë urgjente. Për shkak rreziku të lartë për sigurinë në punë të punëmarrësve janë marë masat në 7% të rasteve. Për shkak rreziku të mesëm janë marrë masat në 48% të rasteve dhe për shkak rreziku të ulët janë marrë masat në 43% të rasteve.

Siguria e rrugëkalimeve.

Në inspektimet e kryera, ka rezultuar se në 90% të tyre, rrugë kalimet janë të sigurta. Ndërkohë që nga totali I masave të marra, në 62% këto masa, janë marrë në raste me rrezikshmëri të ulët për sigurinë e punëmarrësve.

Masat mbrojtëse kolektive

Në 88% të inspektimeve të kryera në kantiere, ishin marrë masat mbrojtëse kolektive. Ndërkohë në 108 raste osë në 25% të inspektimeve ka qënë e nevojshme marrja e masave për ndërhyrjen e rregullueshmëri në marjen e këtyre masave.

KONTROLLI I AKTIVITETEVE TË HOTELERI-TURIZMIT

Gjatë muajve Qershor - Korrik – Gusht - Shtator 2018, ISHPSHSH, ka kontrolluar gjithsej 850 subjekte me aktivitet të shtuar në sezonin e verës, me total 9069 punëmarrës të evidentuar në këtë periudhë. (mesatarisht 10.7 punëmarrës për subjekt), për evidentimin dhe kontrollin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sezonin turistik.

Risi në inspektimet e kësaj periudhe ka qënë dhe evidentimi i subjekteve me detyrim ligjor për punësim të rojeve të plazhit. Në total janë konstatuar, 16 roje plazhi me instruktimin e nevojshëm teknik. Ndër parregullsitë e vëna re në lidhje me rojet e plazhit ishin orët e punës mbi 40 orë në ditë, e ndërkohë pagesa e tyre në 73% të konstatimeve ishte paga minimale.


Të dhëna nga kontrolli i hotel-bar-restoranteve, në sezon turistik janë:

- 850 inspektime në këtë sezon.
- rritje në numrin mesatar të punëmarrësve për subjekt, krahasimisht me vitet e tjera ku nga një mesatare me 7 punëmarrës për subjekt, në këto aktivitete në periudhë sezoni, sot numëron rreth 11 punëmarrës për subjekt, evidentuar gjatë inspektimeve.
- Rreth 7% e punëmarrësve të evidentuar në punë punonin pa kontratë individuale.
- 154 punëmarrës punonin krejtësisht në të zezë, e ku gjatë procesit të inspektimit u siguruan 95% e tyre.
- 97 punëmarrës ishin nën moshën 18 vjeç, e ndërkohë gjatë kësaj periudhe 120 punëmarrës të mitur kanë marrë autorizimin e ISHPSHSH-së, të punonin konform legjislacionit në fuqi në këto aktivitete, shifër kjo që përbën 40% të punëmarrësve të mitur të autorizuar për vitin 2018.
- Në 83 subjekte, për shkeljet flagrante të legjislacionit të punës është marrë masa administrative “pezullim”. (në 10% të kontrolleve).
- Në 210 subjekte për shkeljet e legjislacionit të punës është marrë masa administrative “paralajmërim” (në 25% të kontrolleve).
- Në 8 subjekte për shkeljet e legjislacionit të punës është marrë masa administrative “gjobë” (në 1% të kontrolleve).
- 67% e punëmarrësve të evidentuar në këto subjekte, sigurohen me pagë minimale, shifër kjo e lartë, krahasimisht me këtë të dhënë nga inspektimet totale të viti, e cila rezulton vetëm 26%.

Në tabelën e mëposhtme, janë të dhënat mbi subjektet dhe punëmarrësit e evidentuar nga 12 Qarqet Rajonale, të pasqyruara dhe në grafikun 1.1

	Subjekte	Punëmarrës	Mesatare e punëmarrëve për subjekt
Berat	90	313	3.5
Durres	139	2848	20.5
Elbasan	30	214	7.1
Fier	15	112	7.5
Gjirokaster	57	81	1.4
Korce	89	540	6.1
Kukes	34	119	3.5
Lezhe	83	1121	13.5
Shkoder	126	1267	10.1
Vlore	187	2454	13.1
Total	850	9069	10.7

Grafiku 1.1




Kontrolli i subjekteve, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sezonin turistik, ka si qëllim edhe evidentimin e punëmarrësve me turne.

Kështu tabela e mëposhtme, jep në përqindje të punësuarit për cdo degë rajonale sipas regjimit të punës, së evidentuar.

	Punemarres total	Punemarres ne turn te pare	Perqindje e Punëma gjithsej, <u>evidentuar</u> <u>në turn të</u> <u>I-të</u>	Punemarres ne turn te Dyte	Perqindje e Punëma gjithsej, <u>evidentuar</u> <u>në turn të</u> <u>II-të</u>	Punemarres ne turn te Trete	Perqindje e Punëma gjithsej, <u>evidentuar</u> <u>në turn të</u> <u>III-të</u>
Berat	313	234	74.8%	76	24.3%	3	1.0%
Durres	2848	2458	86.3%	373	13.1%	17	0.6%
Elbasan	214	178	83.2%	33	15.4%	3	1.4%
Fier	112	79	70.5%	31	27.7%	2	1.8%
Gjirokaster	81	76	93.8%	5	6.2%	0	0.0%
Korce	540	339	62.8%	191	35.4%	10	1.9%
Kukes	119	73	61.3%	46	38.7%	0	0.0%
Lezhe	1121	660	58.9%	421	37.6%	40	3.6%
Shkoder	1267	874	69.0%	389	30.7%	4	0.3%
Vlore	2454	1697	69.2%	685	27.9%	72	2.9%
Total	9069	6668	73.5%	2250	24.8%	151	1.7%

Të shprehur dhe në grafik këto të dhëna paraqesin punën e çdo dege rajonale.

Grafiku 1.2




Evidentimi i punëmarrësve në këto aktivitete e sidomos i punëmarrësve që punojnë në turn të dytë apo të tretë ka si qëllim inspektimin e marrëdhënies së punës konform ligjit, e të bazuar në një kontratë punë korrekte.

Kështu, të dhënat mbi numrin e punëmarrësve evidentuar në punë pakontrata pune, flasin për 570 ose 6.3% e totalit të punëmarrësve të evidentuar, që punojnë pa patur një kontratë pune individuale, e kur kjo shifër në inspektimet e vitit 2018, është 1.3%.

Këto të dhëna për çdo degë rajonale jepen si më poshtë:

	Subjekte	Punemarres gjithes te evidentuar	Nr i Punëm gjithsej pa kontrate individuale	Perqindja e Punëm evidentuar pa kontrate individuale
Berat	90	313	66	21.1%
Durres	139	2848	114	4.0%
Elbasan	30	214	0	0.0%
Fier	15	112	2	1.8%
Gjirokaster	57	81	22	27.2%
Korce	89	540	13	2.4%
Kukes	34	119	15	12.6%
Lezhe	83	1121	106	9.5%
Shkoder	126	1267	56	4.4%
Vlore	187	2454	176	7.2%
Total	850	9069	570	6.3%


Grafikisht të dhënat mbi punëmarrësit e evidentuar në punë pa një kontratë pune për 12 degët rajonale janë:



Punësimi informal (ku përfshihen të gjithë punëmarrësit e evidentuar në punë në subjektet e liçensuara e për të cilët nuk derdhet kontributi i Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore), në këto aktivitete, rezulton 154. Me masat e marra në këtë periudhë për t'i futur në skemën e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore rezulton se 99% ose 146 punëmarrës tashmë rezultojnë të futur në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si rezultat i punës së bërë në këto inspektime.

Sipas degëve rajonale këto konstatime rezultojnë

	Subjekte	Punemarres gjithes te evidentuar	Nr i Punëm informal te evidentuar	Perqindja e Punëm informal te evidentuar kundrejt totali te punemarresve, ne keto aktivitete
Berat	90	313	9	2.9%
Durres	139	2848	14	0.5%
Elbasan	30	214	6	2.8%
Fier	15	112	11	9.8%
Gjirokaster	57	81	6	7.4%
Korce	89	540	21	3.9%
Kukes	34	119	15	12.6%
Lezhe	83	1121	3	0.3%
Shkoder	126	1267	48	3.8%
Vlore	187	2454	21	0.9%
Total	850	9069	154	1.7%




Gjatë inspektimeve në aktivitetet e sezonit turistik rezulton që në 83 subjekte të jenë marrë masa urgjente “pezullim” për shkelje flagrante të marrëdhënieve të punës, ose e thënë ndryshe 10% e totalit të aktiviteteve të kontrolluara në këtë sezon.

Sipas degëve rajonale procesi i pezullimit të aktiviteteve për marrëdhënie pune jokorrekte, rezulton si më poshtë:

	Nr i subjekteve te inspektuara	Nr. Subj. me m. urgjente (per marredhenie pune	Nr i Punëm informal te evidentuar	Nr. Punëm gjithsej, qe u futen ne skemen e Sig
Berat	90	8	9	9
Durres	139	4	14	14
Elbasan	30	5	6	6
Fier	15	5	11	11
Gjirokaster	57	0	6	0
Korce	89	11	21	21
Kukes	34	8	15	15
Lezhe	83	1	3	1
Shkoder	126	30	48	48
Vlore	187	11	21	21
Total	850	83	154	146


Aktivitete të pezulluara për marrëdhënie pune jokorrekte në përqindje kundejt totalit të inspektimeve për cdo degë, gjatë kontrolleve të aktiviteteve të hoteleri turizmit.



	Nr i subjekteve te inspektuara	Nr. Subj. me maseadministrative “Paralajmerim”	Nr. Subj. me masesdministrative “gjobe”	Vlere e gjobave (.000)
Berat	90	78	0	0
Durres	139	7	4	80
Elbasan	30	2	0	0
Fier	15	3	0	0
Gjirokaster	57	0	0	0
Korce	89	7	1	50
Kukes	34	2	3	200
Lezhe	83	34	0	0
Shkoder	126	2	0	0
Vlore	187	75	0	0
Total	850	210	8	330

Te shprehuar në përqindje subjekte me dhe pa dënime administrative gjatë inspektimeve të kryera në sezoni turistik sipas degëve rajonale rezultojnë

	% e subjekteve pa mase administrative kundrejt totalit	% e subjekteve administrative “Paralajmerim” kundrejt totalit	% e subjekteve administrative “gjobe” kundrejt totalit
Berat	13.3%	86.7%	0.0%
Durres	92.1%	5.0%	2.9%
Elbasan	93.3%	6.7%	0.0%
Fier	80.0%	20.0%	0.0%
Gjirokaster	100.0%	0.0%	0.0%
Korce	91.0%	7.9%	1.1%
Kukes	85.3%	5.9%	8.8%
Lezhe	59.0%	41.0%	0.0%
Shkoder	98.4%	1.6%	0.0%
Vlore	59.9%	40.1%	0.0%
Total	74.4%	24.7%	0.9%



INSPEKTIMET E SUBJEKTEVE MEDIATIKE PRIVATE E SHTETERORE

Gjatë muajit qershor 2018 janë inspektuar **88 subjekte mediatike private e shteterore**, me 3004 punëmarrës të evidentuar ose mesatarisht 34 punëmarrës për subjekt.

Sipas degëve rajonale rezultojnë:

Deget Rajonale	Total Inspektime (Media)	Punemarres te evidentuar	Punemarrese femar	Mesatare e punemarresve per subjekt
Berat	2	3	1	1.5
Diber	2	17	8	8.5
Durres	4	16	5	4.0
Elbasan	15	89	32	5.9
Fier	5	17	6	3.4
Gjirokaster	3	28	10	9.3
Korce	5	64	19	12.8
Kukes	2	17	8	8.5
Lezhe	3	6	2	2.0
Shkoder	9	58	14	6.4
Tirane	26	2531	1116	97.3
Vlore	12	158	51	13.2
Total	88	3004	1272	34.1

Peshën kryesore të subjekteve mediatike, e zënë mediat në Rajonin e Tiranës me 29.5% të totalit dhe me një numër mesatar punëmarrësish prej 97 vetë.

Nga të dhënat e inspektimeve rezultojnë se, nuk ka të punësuar nën 18-vjeç, ndërkohë që punëmarrës me kohë të pjesshme rezultojnë 30 punëmarrës ose rreth 1% e punëmarrësve në total.

Në lidhje me zbatueshmërinë e legjislacionit të punës, në drejtim të marrëdhënieve të punës, gjatë inspektimeve të kryera në këto aktivitete kanë rezultuar këto shifra:

- Punëmarrës me kontrata individuale pune të lidhura janë në masën 98.7%
- Punëmarrës evidentuar në punë, në turn të dytë në kuptim të Kodit të Punës, janë në masën 17.8%.
- Punëmarrës evidentuar në punë, në turn të tretë në kuptim të Kodit të Punës, janë në masën 0.5%
- Punëmarrës informal të evidentuar janë 5, e ku 2 ishin punëmarrëse femra, dhe tashme me marrjen e masave ligjore gjatë procesit të inspektimit, këta punëmarrës janë pjesë e kontributeve shoqërore e shëndetësore.
- Rreth 2% e punëmarrësve janë konstatuar të punojnë mbi 40 orë në javë.
- Për 2.5% të punëmarrësve të evidentuar, kryejnë leje vjetore të paguar nën 28 ditë kalendarike.

Për shkejet e evidentuara në 88 inspektimet e kryera në subjektet mediatike, janë marrë 2 masa administrative “Pezullim” për shkelje flagrante të dispozitave ligjore për marrëdhënie pune, dhe 12 masa administrative “Paralajmërim”.

Shkeljet e konstatuara në kontrollet e ushtruara në subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e shërbimeve të mediave konsistojnë në lidhje me:

- **Kodin e Punës “Ligji 7961, datë 12.07.1995” *i ndryshuar***

Detyrat e lëna kanë qenë në drejtim të: formës së kontratës së punës; kualifikimit të punëmarrësve; marrjes së masave mbrojtëse marrjes së masave të përgjithshme; kohëzgjatjes së kontratës së punës; shtesave mbi pagë; pajisjeve individuale; ndihmës së shpejtë; mjetet fikëse; punës në ditën e diel ose në ditët e festave zyrtare; regjistrin që mban punëdhënësi për punëmarrësit; kohëzgjatjes së pushimeve vjetore; përlogaritjes së pagës.

- **Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë “Ligji 10237, datë 18.02.2010” *i ndryshuar***

Detyrat e lëna kanë qenë në drejtim të: ndihmës së parë, mbrojtjen kundër zjarrit dhe evakuimin e punëmarrësve; garantimit të punëdhënësit për garantimin e zbatimit të masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale; përpilimi të dokumentit të vlerësimit të rrishtit; informimit të punëmarrësve për masat e sigurisë për të shmangur pasojat e rrezikshme; kontraktimi i shërbimeve të specializuara jashtë ndërmarrjes për mbrojtjen dhe parandalimin e rrezikut; pajisjes me ekzaminime mjeko-ligjore para marrjes në punë.

- **Ligjin për Nxitjen e Punësimit “Ligji 7995, datë 20.09.1995” *i ndryshuar***

Detyrat e lëna kanë qenë në drejtim të: detyrimeve të punëdhënësit, për të deklaruar pranë zyrave të punësimit çdo vend të lire pune; detyrimeve të punëdhënësve për të deklaruar pranë zyrave të punësimit ku ushtrohet aktiviteti; çdo punëdhënës është i detyruar të raportojë çdo tre muaj pranë zyrave të punësimit; plotësimit të librezave të punës.

Ndaj këtyre subjekteve është ndërmarrë dënimi administrativ kryesor, paralajmërim.